



PËRFAQËSUESJA E LARTË  
E BASHKIMIT EVROPIAN  
PËR PUNËT E JASHTME  
DHE POLITIKAT E SIGURISË

Bruksel, 05/12/2018  
Komunikatë e përbashkët  
përfundimtare (2018) 36

**KOMUNIKATË E PËRBASHKËT PËR PARLAMENTIN EVROPIAN,  
KËSHILLIN EVROPIAN, KËSHILLIN, KOMITETIN EVROPIAN  
EKONOMIK DHE SOCIAL DHE KOMITETIN E RAJONEVE**

**Plan Veprimi kundër Dezinformimit**

## 1. HYRJJE

**Liria e shprehjes është një vlerë thelbësore e Bashkimit Evropian e mishëruar në Kartën e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, si dhe në kushtetutat e Shteteve Anëtare.** Shoqëritë tona të hapura demokratike varen nga mundësia e qytetarëve për të pasur qasje në një sërë informacionesh të verifikueshme, në mënyrë që të krijojnë një pikëpamje për çështje të ndryshme politike. Në këtë mënyrë, qytetarët mund të marrin pjesë në mënyrë të informuar në debate publike dhe të shprehin vullnetin e tyre përmes proceseve politike të lira dhe të ndershme. Këto procese demokratike po sfidohen gjithnjë e më shumë nga përhapja e qëllimshme, në shkallë të gjerë dhe sistematike e dezinformimit.

**Dezinformimi kuptohet si informacion i verifikueshëm i rremë apo mashtrues që krijohet, paraqitet dhe shpërndahet për përfitime ekonomike ose për të mashtruar qëllimisht publikun, dhe që mund të shkaktojë dëm publik<sup>1</sup>.** Dëmi publik përfshin kërcënime ndaj proceseve demokratike, si dhe ndaj mallrave publike, siç janë shëndeti i qytetarëve të Bashkimit Evropian, mjedisi apo siguria. Dezinformimi nuk përfshin gabimet e paqëllimshme, satirën dhe parodinë, apo lajme dhe komente partiake të identifikuara qartë. Veprimet e përfshira në këtë Plan Veprimi kanë të bëjnë vetëm me përmbajtjen dezinformuese që është ligjore sipas ligjit të Bashkimit Evropian apo ligjit kombëtar. Ato nuk paragjykojnë ligjet e Bashkimit Evropian apo të ndonjë prej Shteteve Anëtare që mund të jenë të zbatueshme, duke përfshirë rregullat për përmbajtjen e paligjshme<sup>2</sup>.

Pas sulmit kimik në Salisbury dhe konkluzioneve<sup>3</sup> të Këshillit Evropian lidhur me të, Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë paraqitën një Komunikatë të Përbashkët për forcimin e qëndrueshmërisë ndaj kërcënimeve hibride<sup>4</sup>, që vuri në dukje komunikimin strategjik si një fushë prioritare për punën e mëtejshme. Më pas, Këshilli Evropian ftoi "*Përfaqësuesen e Lartë dhe Komisionin të paraqesin, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare dhe në përputhje me konkluzionet e Këshillit Evropian të marsit 2015, një plan veprimi deri në dhjetor 2018, me propozime specifike për një reagim të koordinuar ndaj sfidës të dezinformimit, përfshirë mandatet e duhura dhe burimet e mjaftueshme për ekipet përkatëse të Komunikimeve Strategjike të EEAS-së*".<sup>5</sup>

Ky Plan Veprimi i përgjigjet thirrjes së Këshillit Evropian për masa për "*mbrojtjen e sistemeve demokratike të Bashkimit Evropian dhe për luftën kundër dezinformimit, duke përfshirë edhe në kontekstin e zgjedhjeve të ardhshme evropiane*".<sup>6</sup> Ai bazohet në nismat ekzistuese të Komisionit, si dhe në punën e Grupit të Punës së Komunikimit Strategjik Lindor të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm. Ai përcakton veprimet që duhet të ndërmerren nga Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë, me ndihmën e Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare dhe Parlamentin Evropian. Ky plan përfshin kontributin e marrë nga Shtetet Anëtare, duke përfshirë edhe nëpërmjet diskutimeve në Këshill<sup>7</sup>, në Komitetet e Përfaqësuesve të Përhershëm I dhe II, në Komisionin për Sigurinë Politike, grupet përkatëse të punës të Këshillit dhe takimet e drejtorëve të komunikimit strategjik, si dhe atyre politikë të Ministrive të Punëve të Jashtme. Ai gjithashtu merr parasysht

<sup>1</sup> Komunikatë për trajtimin e dezinformimit në rrjet, COM (2018) 236.

<sup>2</sup> Komisioni propozoi masa të përcaktuara për trajtimin e përhapjes së përmbajtjeve të paligjshme në internet, duke përfshirë Rekomandimin mbi masat për trajtimin efektiv të përmbajtjes së paligjshme në internet (C (2018) 1177). Shih gjithashtu propozimin për një Rregullore mbi parandalimin e përhapjes së përmbajtjes terroriste në internet COM (2018) 640 si dhe Direktivën e rishikuar të Shërbimeve të Medias Audio-vizuale të miratuar më 6 nëntor 2018.

<sup>3</sup> Konkluzionet e Këshillit Evropian, 22 mars 2018.

<sup>4</sup> Deklarata e përbashkët (2018) 16.

<sup>5</sup> Konkluzionet e Këshillit Evropian, 28 qershor 2018.

<sup>6</sup> Konkluzionet e Këshillit Evropian, 18 tetor 2018.

<sup>7</sup> Shih debatin politik mbi "Përballimin e përhapjes së dezinformimit në internet: Sfidat për ekosistemin e medias" dhe konkluzionet e Këshillit të 27 nëntorit 2018.

bashkëpunimi me partnerët kyçë të Bashkimit Evropian, përfshirë Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior dhe Grupin 7 (G7)<sup>8</sup>.

**Komunikata për trajtimin e dezinformimit në internet (Komunikata e prillit) theksoi rolin kyç të luajtur nga shoqëria civile dhe sektori privat (sidomos platformat e medieve sociale) në trajtimin e problemit të dezinformimit.** Në vazhdimësi, platformat në internet dhe industria e reklamave ranë dakord për një Kod të Praktikës në shtator 2018, për rritjen e transparencës në internet dhe mbrojtjen e qytetarëve, veçanërisht në funksion të zgjedhjeve të Parlamentit Evropian të vitit 2019, por edhe në një perspektivë më afatgjatë. Tashmë është thelbësore që këta aktorë të përmbushin objektivat e përcaktuara nga Komisioni në prill dhe t'i përmbahen plotësisht Kodit të Praktikës<sup>9</sup>. Përveç kësaj, është duke u zhvilluar një rrjet i pavarur i verifikuesve të fakteve për të rritur aftësinë për zbulimin dhe ekspozimin e dezinformimeve, si dhe po bëhen përpjekje të qëndrueshme në nivel të Bashkimit Evropian dhe në nivel kombëtar për të mbështetur njohuritë mediatike.

Ky Plan Veprimi shoqërohet nga një raport progresi mbi Komunikatën e prillit<sup>10</sup>. Ky raport përcakton progresin e arritur në veprimet e ndryshme, veçanërisht në lidhje me Kodin e Praktikës, duke nxitur një ekosistem të sigurt, të besueshëm dhe të përgjegjshëm në rrjet, aktivitete të lidhura me rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohuritë mediatike, si dhe mbështetje për mediet e pavarura dhe gazetarinë cilësore.

**Këshilli Evropian e njohu fillimisht kërcënimin e fushatave online të dezinformimit në vitin 2015**, kur i kërkoi Përfaqësueses së Lartë të adresonte fushatat e dezinformimit nga Rusia. Grupi i Punës i Komunikimit Strategjik Lindor u ngrit për të adresuar dhe rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje. Përveç kësaj, Komunikata e Përbashkët mbi Luftën kundër Kërcënimeve Hibride<sup>11</sup> krijoi Qelizën kundër kërcënimeve hibride brenda Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, për të vepruar si një fokus i vetëm për analizën e kërcënimeve hibride. Ai gjithashtu çoi në ngritjen e Qendrës Evropiane të Ekselencës për Luftën kundër Kërcënimeve Hibride, e cila ndan praktikatat më të mira dhe mbështet aktivitetet e Bashkimit Evropian dhe të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në këtë fushë.

**Duke pasur parasysh zgjedhjet e Parlamentit Evropian të vitit 2019 dhe më shumë se 50 zgjedhje presidenciale, kombëtare apo vendore / rajonale që mbahen në Shtetet Anëtare deri në vitin 2020, është urgjente që të rriten përpjekjet për të siguruar procese demokratike të lira dhe të ndershme.** Kërcënimet që prekin demokracinë në çdo Shtet Anëtar mund ta dëmtojnë Bashkimin Evropian në tërësi. Për më tepër, dezinformimi shpesh synon institucionet evropiane dhe përfaqësuesit e tyre, si dhe synon të minojë vetë projektin evropian në përgjithësi. Më 12 shtator 2018, Komisioni miratoi masa<sup>12</sup> për të siguruar zgjedhje evropiane të lira dhe të ndershme, si dhe rekomandoi përdorimin e sanksioneve aty ku ishte e përshtatshme, duke përfshirë për përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale

<sup>8</sup> Në Angazhimin Charlevoix për Mbrojtjen e Demokracisë nga Kërcënimet e Jashtëm, liderët e G7-s u angazhuan për të ndërmarrë veprime të përbashkëta për t'u përgjigjur aktorëve të huaj që përpiqen të minojnë shoqëritë dhe institucionet tona demokratike, proceset tona zgjedhore, sovranitetin tonë dhe sigurinë tonë.

<sup>9</sup> Shih gjithashtu konkluzionet e Këshillit të 27 nëntorit 2018.

<sup>10</sup> Komunikata (2018) 794.

<sup>11</sup> Ndërsa përkufizimet e kërcënimeve hibride ndryshojnë dhe duhet të mbeten fleksibël për t'u përgjigjur natyrës së tyre në zhvillim, koncepti kap kombinimin e veprimtarisë shtrënguese dhe subversive, metodave konvencionale dhe jo-konvencionale (d.m.th., diplomatike, ushtarake, ekonomike, teknologjike), të cilat mund të përdoren në një mënyrë të koordinuar nga aktorët shtetërorë apo joshtetërorë për të arritur objektiva specifike, duke mbetur nën pragun e luftës zyrtarisht të deklaruar. Zakonisht theksi vihet te shfrytëzimi i dobësive të objektivit dhe krijimi i paqartësive për të penguar proceset e vendimmarrjes. Fushatat masive të dezinformimit, duke përdorur mediet sociale për të kontrolluar narrativën politike ose për të radikalizuar, rekrutuar dhe drejtuar aktorët e autorizuar mund të jenë mjete për kërcënime hibride. Shih Deklaratën e përbashkët (2016) 18.

<sup>12</sup> Për një pasqyrë të plotë të masave, shih Komunikatën mbi garantimin e zgjedhjeve evropiane të lira dhe të ndershme, Komunikata finale (2018) 637.

për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve<sup>13</sup>. Përveç kësaj, është urgjente që Shtetet Anëtare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ruajtur integritetin e sistemeve dhe infrastrukturës së tyre elektorale, si dhe t'i testojnë ato përpara zgjedhjeve evropiane.

**Fushatat e dezinformimit, sidomos nga vendet e treta, shpesh janë pjesë e luftës hibride<sup>14</sup>, që përfshin sulmet kibernetike dhe piraterinë e rrjeteve<sup>15</sup>.** Dëshmitë tregojnë se aktorë të shteteve të huaja po përdorin gjithnjë e më shumë strategji dezinformimi për të ndikuar në debatet shoqërore, për të krijuar ndarje, si dhe për të ndërhyrë në vendimmarrjen demokratike. Këto strategji synojnë jo vetëm Shtetet Anëtare, por edhe vendet partnere në fqinjët e lindjes, si dhe në vendet jugore, në Lindjen e Mesme dhe Afrikë.

Dezinformimi i prodhuar dhe / ose i përhapur nga burimet ruse është raportuar në kontekstin e disa zgjedhjeve dhe referendumeve në BE<sup>16</sup>. Fushatat e dezinformimit të lidhura me luftën në Siri<sup>17</sup>, me rrëzimin e avionit MH-17 në Lindje të Ukrainës<sup>18</sup>, si dhe me përdorimin e armëve kimike në sulmin e Salisbury-t<sup>19</sup> janë dokumentuar mirë.

## 2. DEZINFORMIMI: KUPTIMI I RREZIQEVE DHE FORCIMI I REAGIMIT EVROPIAN

**Dezinformimi është një kërcënim në zhvillim, i cili kërkon përpjekje të vazhdueshme për të adresuar aktorët përkatës, vektorët, mjetet, metodat, objektivat prioritare dhe ndikimin.** Disa forma, sidomos dezinformimi i shtyrë nga shteti, janë analizuar nga Celula e BE-së për luftën kundër kërcënimeve hibride, në bashkëpunim me Grupet e Punës të Komunikimit Strategjik të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, si dhe me mbështetjen e shërbimeve të Shteteve Anëtare.

Aktorët që qëndrojnë pas dezinformimit mund të jenë të brendshëm, brenda Shteteve Anëtare, ose të jashtëm, duke përfshirë aktorët shtetërorë (apo të sponsorizuar nga qeveria) dhe jo-shtetërorë. Sipas raporteve<sup>20</sup>, më shumë se 30 vende përdorin dezinformimin dhe aktivitetet influencuese në forma të ndryshme, duke përfshirë edhe në vetë vendet e tyre. Përdorimi i dezinformimit nga aktorët brenda Shteteve Anëtare është një burim shqetësimi në rritje në të gjithë Bashkimin Evropian. Raste të dezinformimit të nxitura nga aktorët jo-shtetërorë janë raportuar gjithashtu në Bashkimin Evropian, për shembull lidhur me vaksinimin<sup>21</sup>. Sa i takon aktorëve të jashtëm, provat janë të forta në rastin e Federatës Ruse. Megjithatë, edhe vende të

<sup>13</sup> Këto sanksione u shtohen atyre të parashikuara nga Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (Rregullorja 2016/679).

<sup>14</sup> Korniza e Përbashkët për luftën kundër kërcënimeve hibride: një reagim i Bashkimit Evropian, Komunikatë e përbashkët përfundimtare (2016) 18.

<sup>15</sup> Këto sulme kibernetike mund të përfshijnë ndërhyrje të shënjestruara për të mbledhur informacion sensitiv si pararendës për rrjedhje informacioni apo rrjedhje të infektuara informacioni, pushtimin e llogarive të medieve sociale, llogaritë e medieve sociale të drejtuara nga robotë dhe përçarje të sistemeve të teknologjisë së informacionit, për shembull, kompanitë transmetuese ose komisionet zgjedhore.

<sup>16</sup> Shih, për shembull, raportin e Stafit të Planifikimit të Politikave dhe Institutit për Kërkimin Strategjik të Francës: [https://www.diplomatie.gouv.fr/IMG/pdf/information\\_manipulation\\_rvb\\_cle838736.pdf](https://www.diplomatie.gouv.fr/IMG/pdf/information_manipulation_rvb_cle838736.pdf).

<sup>17</sup> Deklaratë e përbashkët e 17 vendeve anëtare të Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW) mbi sulmet kimike në Douma, Siri:

<https://www.diplomatie.gouv.fr/en/french-foreign-policy/manipulation-of-information/article/syria-chemical-attacks-in-douma-7-april-joint-statement-by-france-and-16--other>.

<sup>18</sup> Mbi fushatën e dezinformimit për MH-17, shih Grupin e Punës të Komunikimit Strategjik Lindor: <https://euvsdisinfo.eu/mh17-time-is-running-out-for-disinformation/> dhe <https://euvsdisinfo.eu/flight-mh-17-three-years-on-getting-the-truth-out-of-eastern-ukraina/> si dhe deklaratën e Ekipit të Përbashkët Hetimor: <https://www.om.nl/onderwerpen/mh17-crash@104053/reaction-jit-to/>.

<sup>19</sup> <https://euvsdisinfo.eu/timeline-how-russia-built-two-major-disinformation-campaigns/>

Për operacionin kibernetik të Rusisë me objektivi OPCW në Hagë, shih:

<https://www.government.nl/latest/news/2018/10/04/netherlands-defence-intelligence-and-security-service-disrupts-russian-cyber-operation-targeting-opcw>.

<sup>20</sup> Shih: <https://freedomhouse.org/report/freedom-net/freedom-net-2017>.

<sup>21</sup> Shih Komunikatën (2018) 245 dhe Komunikatën (2018) 244.

tjera të treta përdorin gjithashtu strategji të dezinformimit, duke mësuar me shpejtësi nga metodat e Federatës Ruse.

Sipas Qelizës së BE-së për luftën kundër kërcënimeve hibride, dezinformimi nga Federata Ruse<sup>22</sup> përbën kërcënimin më të madh për BE-në. Ai është sistematik, i pajisur mirë dhe në një shkallë tjetër krahasuar me vendet e tjera. Sa i përket koordinimit, niveleve të shënjestrimit dhe implikimeve strategjike, dezinformimi i Rusisë përbën një pjesë të një kërcënimi më të gjerë hibrid që përdor një numër mjetesh, levash, si dhe aktorë jo-shtetërorë.

Fushatat e vazhdueshme të shënjestruara të dezinformimit kundër Bashkimit Evropian, institucioneve dhe politikave të tij, ka gjasa të shtohen me fillimin e zgjedhjeve të Parlamentit Evropian të vitit 2019. **Kjo kërkon veprim të menjëhershëm dhe urgjent për të mbrojtur Bashkimin Evropian, institucionet dhe qytetarët e tij kundër dezinformimit.**

Mediet sociale janë bërë mjete të rëndësishme për përhapjen e dezinformimit, duke përfshirë në disa raste, si Cambridge Analytica, objektivin e shpërndarjes së përmbajtjes së dezinformimit tek përdorues të caktuar, të cilët identifikohen nga qasja dhe përdorimi i paautorizuar i të dhënave personale me qëllimin përfundimtar ndikimin në rezultatet e zgjedhjeve. Dëshmitë e kohëve të fundit tregojnë se shërbimet e mesazheve private përdoren gjithnjë e më shumë për përhapjen e dezinformimeve<sup>23</sup>. Teknikat përfshijnë manipulimin e videove (deep-fake) dhe falsifikimin e dokumenteve zyrtare; përdorimin e softuerëve të automatizuar të internetit (robotë) për të përhapur dhe përforcuar përmbajtjen përçarëse dhe debatet në mediet sociale; sulmet nga përdorues *troll* në profilet e medie sociale dhe vjedhjen e informacionit. Në të njëjtën kohë, metodat më tradicionale si televizioni, gazetat, faqet e internetit dhe email-et zinxhir vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në shumë rajone. Mjetet dhe teknikat e përdorura po ndryshojnë me shpejtësi – **reagimi duhet të evoluojë po aq shpejt.**

Përveç ndërmarrjes së veprimeve brenda Shteteve Anëtare dhe Bashkimit Evropian, Bashkimi Evropian ka një interes të rëndësishëm për të punuar me partnerët në tre rajone prioritare – me fqinjët lindorë dhe jugorë të Bashkimit dhe në Ballkanin Perëndimor. Ekspozimi i dezinformimeve në vendet fqinje të Bashkimit është komplementar për të trajtuar problemin brenda Bashkimit Evropian.

**Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm ka ngritur grupe pune të posaçme të komunikimit strategjik**, të përbërë nga ekspertë me aftësitë dhe njohuritë e duhura gjuhësore, për trajtimin e çështjes dhe për hartimin e strategjive të reagimit. Ata po punojnë ngushtësisht me shërbimet e Komisionit për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme komunikimi në rajone.

Bazuar në Planin e Veprimit për Komunikimin Strategjik, miratuar më 22 qershor 2015, mandati i Grupit të Punës të Komunikimit Strategjik Lindor përbëhet nga tre elementë veprimi: (i) Komunikimi efektiv dhe promovimi i politikave të Bashkimit ndaj vendeve të Lindjes; (ii) Fuqizimi i mjedisit të përgjithshëm mediatik në vendet lindore dhe në Shtetet Anëtare, duke përfshirë mbështetjen për lirinë e medias dhe forcimin e medie të pavarura, dhe (iii) Përmirësimi i kapacitetit të Bashkimit Evropian për të parashikuar, adresuar dhe për t'iu përgjigjur aktiviteteve të dezinformimit nga Federata Ruse. Në përgjigje të konkluzioneve të Këshillit në dhjetor 2015 dhe qershor 2017, Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm ngriti dy grupe pune shtesë: Grupin e Punës të Ballkanit Perëndimor<sup>24</sup> për rajonin korrespondues

<sup>22</sup> Doktrina ushtarake ruse e njeh në mënyrë eksplicite luftën e informacionit si një nga domenet e saj: <https://www.rusemb.org.uk/press/2029>.

<sup>23</sup> Sipas Universitetit të Oksfordit, platformat e mesazheve të drejtpërdrejta kanë organizuar fushata dezinformimi në të paktën 10 vende këtë vit.

<sup>24</sup> Konkluzionet e Këshillit mbi Procesin e Zgjerimit, dhe të Stabilizimit dhe Asociimit të 15 Dhjetorit 2015.

dhe Grupin e Punës Jugu<sup>25</sup> për vendet në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, si dhe për rajonin e Gjirit.

Që kur u krijua, Grupi i Punës i Komunikimit Strategjik Lindor ka komunikuar në mënyrë efektive mbi politikat e Bashkimit Evropian në fqinjët lindorë të Bashkimit, kryesisht përmes një qasjeje të udhëhequr nga fushatat. Përveç kësaj, Grupi i Punës i Komunikimit Strategjik Lindor ka regjistruar, analizuar dhe vënë në qendër të vëmendjes mbi 4,500 shembuj të dezinformimit nga Federata Ruse, duke zbuluar narrativa të shumta dezinformuese, duke rritur ndërgjegjësimin, si dhe duke ekspozuar mjetet, teknikat dhe synimet e fushatave të dezinformimit. Fokusi i tij është te vendet e Partneritetit Lindor dhe mediet ruse, vendase dhe ndërkombëtare, dhe qasja e tij është ekspozimi, në bazë të provave të grumbulluara, i tendencave, narrativave, metodave dhe kanaleve të përdorura, si dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi to.

**Prandaj, mandati i Grupit të Punës së Komunikimit Strategjik Lindor duhet të ruhet dhe mandati i dy Grupeve të tjera të Punës të Komunikimit Strategjik (Ballkani Perëndimor dhe Jugu) duhet rishikuar në dritën e shkallës dhe rëndësisë në rritje të aktiviteteve të dezinformimit në ato rajone dhe nevojës për të rritur ndërgjegjësimin mbi ndikimin negativ të dezinformimit.**

### **3. MASAT PËR NJË REAGIM TË KOORDINUAR TË BASHKIMIT EVROPIAN KUNDËR DEZINFORMIMIT**

**Trajtimi i dezinformimit kërkon vendosmëri politike dhe veprime të unifikuara, duke mobilizuar të gjitha segmentet e qeverive** (përfshirë luftën kundër rreziqeve hibride, sigurinë kibernetike, komunitetet e inteligjencës dhe komunikimit strategjik, mbrojtjen e të dhënave, autoritetet zgjedhore, ato të zbatimit të ligjit dhe mediatike). Kjo duhet bërë në bashkëpunim të ngushtë me partnerë me mendime të ngjashme në mbarë globin. Ajo kërkon bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve të Bashkimit Evropian, Shteteve Anëtare, shoqërisë civile dhe sektorit privat, sidomos mes platformave online.

Përgjigja e koordinuar ndaj dezinformimit e paraqitur në këtë Plan Veprimi bazohet në katër shtylla:

- (i) përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve të Bashkimit Evropian për të zbuluar, analizuar dhe ekspozuar dezinformimet;
- (ii) forcimi i reagimeve të koordinuara dhe të përbashkëta ndaj dezinformimit;
- (iii) mobilizimi i sektorit privat për të luftuar dezinformimin;
- (iv) rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë shoqërore.

#### **SHTYLLA 1: PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE TË INSTITUCIONEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË ZBULUAR, ANALIZUAR DHE EKSPOZUAR DEZINFORMIMET**

**Për të adresuar në mënyrë efektive kërcënimin e dezinformimit, është e nevojshme të përforcohen Grupet e Punës të Komunikimit Strategjik të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, delegacionet e Bashkimit Evropian dhe Qeliza e BE-së për luftën kundër kërcënimeve hibride, duke u ofruar atyre staf shtesë të specializuar, siç janë ekspertët për nxjerrjen dhe analizën e të dhënave për përpunimin e të dhënave përkatëse. Gjithashtu është e rëndësishme të kontraktohen shërbime shtesë për monitorimin e medias për të mbuluar një gamë më të gjerë burimesh dhe gjuhësh, si dhe hulumtime dhe studime shtesë mbi shtrirjen dhe ndikimin e dezinformimit. Përveç kësaj, ekziston nevoja për të investuar në mjete analitike, të tilla si softuerët e dedikuar për të zbuluar, organizuar dhe grumbulluar sasi të mëdha të të dhënave digjitale.**

<sup>25</sup> Konkluzionet e Këshillit mbi Luftën kundër Terrorizmit miratuar më 19 qershor 2017.

Përforcimi i ekipeve strategjike të komunikimit të Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm do të bëhet në dy hapa.

Në periudhën afatshkurtër, buxheti për komunikimin strategjik pritet të rritet më shumë se dyfish<sup>26</sup> në vitin 2019 dhe kjo do të shoqërohet me një përforcim të të paktën 11 pozicioneve përpara zgjedhjeve evropiane. Në periudhën afatmesme<sup>27</sup>, do të kërkohen pozicione shtesë të zyrtarëve të përhershëm në ekipet e komunikimit strategjik dhe në Qelizat e BE-së për luftën kundër kërcënimeve hibride në selinë qendrore, si dhe poste të reja në delegacionet e vendeve fqinje, për të arritur një rritje totale prej 50-55 anëtarësh të stafit gjatë dy viteve të ardhshme.

Sinergji të mëtejshme do të zhvillohen ndërmjet shërbimeve të Komisionit dhe Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, për shembull, për ndarjen e mjeteve ose hartimin e fushatave të komunikimit.

**Analizat e kërcënimeve dhe vlerësimet e inteligjencës janë bazë për punën me dezinformimin.** Ekspertiza e Qendrës së Inteligjencës dhe Situatës duhet të përdoret plotësisht për të analizuar natyrën evoluese të fushatave të dezinformimit.

**Grupet e Punës të Komunikimit Strategjik do të punojnë ngushtësisht me delegacionet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe me Komisionin për trajtimin e dezinformimit.** Në veçanti, ato do të bashkëpunojnë me Rrjetin e brendshëm kundër Dezinformimit të Komisionit, të ngritur pas Komunikatës së prillit<sup>28</sup>.

Shtetet Anëtare duhet të plotësojnë dhe t'i mbështesin veprimet e institucioneve të Bashkimit Evropian duke rritur aftësitë e tyre kombëtare dhe duke mbështetur rritjet e nevojshme të burimeve për institucionet e Bashkimit Evropian.

**Veprimi 1:** Duke pasur parasysh zgjedhjet e Parlamentit Evropian në vitin 2019, por edhe perspektivën afatgjatë, Përfaqësuesja e Lartë, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, do të forcojë Grupet e Punës të Komunikimit Strategjik dhe Delegacionet e Bashkimit Evropian nëpërmjet stafit shtesë dhe mjeteve të reja që janë të nevojshme për të zbuluar, analizuar dhe ekspozuar aktivitetet e dezinformimit. Shtetet Anëtare, aty ku është e përshtatshme, duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre kombëtare në këtë fushë, si dhe të mbështesin rritjen e nevojshme të burimeve për Grupet e Punës të Komunikimit Strategjik dhe Delegacionet e Bashkimit Evropian.

**Veprimi 2:** Përfaqësuesja e Lartë do të shqyrtojë mandatet e Grupeve të Punës të Komunikimit Strategjik për Ballkanin Perëndimor dhe Jugun për t'u mundësuar atyre të adresojnë në mënyrë efektive dezinformimin në këto rajone.

## **SHTYLLA 2: FORCIMI I REAGIMEVE TË KOORDINUARA DHE TË PËRBASHKËTA NDAJ DEZINFORMIMIT**

Orët e para pas daljes së dezinformimit janë kritike për zbulimin, analizimin dhe reagimin ndaj tij. Rrjedhimisht, **do të ngrihet një Sistem i Shpejtë Alarmi për të siguruar alarme mbi fushatat e dezinformimit në kohë reale**, përmes një infrastrukture teknologjike të dedikuar. Kjo do të lehtësojë ndarjen e të dhënave dhe vlerësimin, për të mundësuar ndërjegjësimin e përbashkët ndaj situatës, atribuimin dhe reagimin e koordinuar, si dhe për të siguruar kohë dhe burime në mënyrë efikase.

<sup>26</sup> Diskutimet e tanishme mbi buxhetin e vitit 2019 parashikojnë një rritje nga 1.9 milionë Euro në vitin 2018 deri në 5 milionë në vitin 2019.

<sup>27</sup> Përmes amendimeve të buxhetit të vitit 2019 dhe / ose propozimit për buxhetin e vitit 2020.

<sup>28</sup> Ky rrjet përfshin përfaqësuesit e Drejtorive të Përgjithshme të Komisionit dhe të Përfaqësive të tij. Komisioni ka ngritur gjithashtu kohët e fundit një grup pune me Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm dhe Parlamentin Evropian mbi trajtimin e dezinformimit përpara zgjedhjeve evropiane.

Në funksion të krijimit të Sistemit të Shpejtë të Alarmit, **çdo Shtet Anëtar duhet të përcaktojë, në përputhje me strukturën e tij institucionale, një pikë kontakti, pozicionuar në mënyrë ideale në departamentet e komunikimit strategjik.** Kjo pikë kontakti do të ndajë alarmet dhe do të sigurojë koordinim me të gjitha autoritetet e tjera përkatëse kombëtare, si dhe me Komisionin dhe Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm. Kjo nuk cenon kompetencat ekzistuese të autoriteteve kombëtare në kuadrin e ligjit të Bashkimit Evropian dhe / ose atij kombëtar, apo në kuadër të pjesëve të tjera të këtij Plani Veprimi. Aty ku dezinformimi ka të bëjë me zgjedhjet ose me funksionimin e institucioneve demokratike në Shtetet Anëtare, pikat kombëtare të kontaktit duhet të bashkëpunojnë ngushtë me rrjetet zgjedhore kombëtare<sup>29</sup>. Në këtë rast, rezultati i punës së Sistemit të Shpejtë të Alarmit duhet të ndahet me rrjetin zgjedhor të bashkëpunimit evropian<sup>30</sup>, në veçanti për të shkëmbyer informacion mbi kërcënimet që lidhen me zgjedhjet dhe për të mbështetur zbatimin e mundshëm të sanksioneve. Platformat në internet duhet të bashkëpunojnë me pikat e kontaktit duke e mbështetur Sistemin e Shpejtë të Alarmit, sidomos gjatë periudhave zgjedhore, për të siguruar informacion e duhur dhe në kohë.

**Sistemi i Shpejtë i Alarmit duhet të jetë i lidhur ngushtë me aftësitë ekzistuese 24/7,** siç është Qendra Koordinuese për Reagimin ndaj Emergjencave<sup>31</sup> dhe Dhoma e Situatës së Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm<sup>32</sup>. Celula e BE-së për luftën kundër kërcënimeve hibride e Qendrës së Inteligjencës dhe Situatës, si dhe Grupet përkatëse të Punës të Këshillit, mund të përdoren gjithashtu si kanale për shkëmbimin e informacionit. Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë do të sigurojnë shkëmbimin e rregullt të informacionit dhe praktikave më të mira me partnerët kyç, duke përfshirë brenda G7-s dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

**Reagimi i menjëhershëm nëpërmjet komunikimit efektiv dhe të bazuar në fakte është thelbësor për të luftuar dhe parandaluar dezinformimin, duke përfshirë edhe rastet e dezinformimit në lidhje me çështjet dhe politikat e Bashkimit.** Kjo është e rëndësishme për të nxitur një debat të hapur dhe demokratik pa manipulime, duke përfshirë edhe në kontekstin e zgjedhjeve të ardhshme evropiane. Institucionet<sup>33</sup> e Bashkimit Evropian dhe Shtetet Anëtare duhet ta përmirësojnë aftësinë e tyre për të reaguar dhe për të komunikuar në mënyrë efektive. Komisioni e ka rritur tashmë financimin e tij për aktivitete më të mira komunikimi, të zbatuara përmes programeve rajonale të komunikimit, duke përfshirë në vendet fqinje të Bashkimit Evropian, si dhe Delegacionet e Bashkimit Evropian. Institucionet e Bashkimit Evropian janë të gjitha aktive në komunikimin mbi veprimet dhe politikat evropiane në Bashkim, dhe në veçanti Përfaqësimet e Komisionit dhe zyrat ndërlidhëse të Parlamentit Evropian në Shtetet Anëtare luajnë një rol kyç për të siguruar mesazhe të

---

<sup>29</sup> Shih Rekomandimin C (2018) 5949 për rrjetet e bashkëpunimit zgjedhor, transparencën në internet, mbrojtjen kundër incidenteve të sigurisë kibernetike dhe luftën kundër fushatave të dezinformimit në kontekstin e zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Këto rrjete do të bashkojnë autoritetet kombëtare zgjedhore, rregullatorët e medieve audio-vizuale, autoritetet e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave, si dhe grupet përkatëse të ekspertëve, për shembull për njohuritë mediatike. Ato përbëjnë, së bashku me institucionet e Bashkimit Evropian, rrjetin zgjedhor evropian. Rrjeti zgjedhor evropian do të mblidhet për herë të parë në janar 2019.

<sup>30</sup> Ngritur në pajtim me Rekomandimin e nxjerrë më 12 shtator 2018.

<sup>31</sup> Qendra për Koordinimin e Reagimit ndaj Emergjencave është ngritur në bazë të Nenit 7 të Vendimit 1313/2013 /BE mbi Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian.

<sup>32</sup>Dhoma e Situatave është një organ i përhershëm i gatshëm i Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm që siguron mbikëqyrje mbarëbotërore dhe ndërgjegjësime mbi situatën aktuale. Ajo është pjesë e Qendrës së BE-së për Inteligjencën dhe Situatën dhe vepron si qendër informacioni për situatën për të gjithë aktorët relevantë nga institucionet evropiane.

<sup>33</sup> Në Komision, Anëtarët e Kolegjit të Komisionerëve, Shërbimi i Zëdhënësve dhe Përfaqësitë e Komisionit do ta ruajnë rolin e tyre kryesor të ndërhyrjes për garantimin e kundërshtimit sa herë që ka gabime në raportet e medias.



përshtatura në nivel lokal, duke përfshirë mjete specifike për të luftuar mitet dhe për të përhapur faktet<sup>34</sup>.

**Bashkëpunimi midis Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Bashkimit Evropian duhet të forcohet më tej**, veçanërisht në lidhje me shkëmbimin e informacionit, të mësuarit e përbashkët, rritjen e ndërgjegjësimit, mesazhet proaktive dhe hulumtimet. Nevojitet më shumë shkëmbim informacioni ndërmjet Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Bashkimit Evropian për të përmirësuar ndërgjegjësimin mbi situatën dhe kapacitetet e tyre përkatëse të reagimit. Komunikimi proaktiv dhe objektiv mbi vlerat dhe politikatat e Bashkimit Evropian është veçanërisht efektiv kur kryhet direkt nga Shtetet Anëtare. Për këtë qëllim, Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë u bëjnë thirrje Shteteve Anëtare që të intensifikojnë përpjekjet e tyre të komunikimit dhe ta mbrojnë Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij nga fushatat e dezinformimit.

**Veprimi 3:** Deri në mars të vitit 2019, Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, do të krijojnë një Sistem të Shpejtë Alarmi për adresimin e fushatave të dezinformimit, duke punuar ngushtësisht me rrjetet ekzistuese, me Parlamentin Evropian, si dhe me Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Mekanizmin e Reagimit të Shpejtë të G7-s.

**Veprimi 4:** Duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme evropiane, Komisioni, në bashkëpunim me Parlamentin Evropian, do të rritë përpjekjet e tij të komunikimit mbi vlerat dhe politikatat e Bashkimit Evropian. Shtetet Anëtare duhet të forcojnë ndjeshëm përpjekjet e tyre të komunikimit mbi vlerat dhe politikatat e Bashkimit Evropian.

**Veprimi 5:** Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, do të forcojnë komunikimet strategjike në vendet fqinje të Bashkimit Evropian.

### **SHTYLLA 3: MOBILIZIMI I SEKTORIT PRIVAT PËR TË LUFTUAR DEZINFORMIMIN**

Platformat në internet, reklamuesit dhe industria e reklamave kanë një rol vendimtar në trajtimin e problemit të dezinformimit, pasi shkalla e tij lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e platformave për të amplifikuar, shënjestruar dhe përhapur mesazhet dezinformuese të aktorëve me qëllime të këqija. Duke pasur parasysh dështimet e tyre të kaluara për të vepruar siç duhet për trajtimin e këtij problemi, Komisioni u bëri atyre thirrje në prill 2018 që të rrisnin përpjekjet. Në këtë kontekst, më 26 shtator 2018<sup>35</sup> u botua Kodi i Praktikës mbi Dezinformimin. Platformat kryesore online të cilat nënshkruan Kodin e Praktikës, u angazhuan për masa specifike që do të merren para zgjedhjeve të Parlamentit Evropian të vitit 2019.

**Komisioni u bën thirrje të gjithë nënshkruesve të Kodit të Praktikës të zbatojnë masat dhe procedurat e identifikuara në Kod me shpejtësi dhe efektivitet**, në mbarë BE-në, duke u përqendruar te masat urgjente dhe përkatëse për të siguruar integritetin e zgjedhjeve evropiane të vitit 2019. Në veçanti, platformat e mëdha online duhet menjëherë (i) të

<sup>34</sup> Disa Përfaqësi të Komisionit kanë zhvilluar mjete të adaptuara në nivel lokal për të demaskuar dezinformimin, si “Les Décodeurs de l’Europe” në Francë, “UE Vero Falso” në Itali, “Euromyty.sk” në Sllovaki, si dhe konkursi vizatimor për goditjen e miteve në Austri dhe seritë vizatimore në Rumani.

<sup>35</sup> <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/code-practice-disinformation> . Më 16 tetor, nënshkruesit fillestarë të Kodit siguruan abonimet e tyre formale në Kod, duke identifikuar angazhimet të cilave secili nënshkrues do tui përmbahej, si dhe një tabelë që rendit praktikatat më të mira të kompanive përkatëse dhe piketat për zbatimin e përgjithshëm të Kodit në BE. Nënshkruesit fillestarë përfshijnë platformat kryesore online (Facebook, Google, Youtube, Twitter), ofruesit e softuerëve (Mozilla), reklamuesit, si dhe një numër shoqatash profesionale që përfaqësojnë platformat online dhe industrinë e reklamave. Kodi i Praktikës duhet të krijojë një ekosistem online më transparent, më të besueshëm dhe më të përgjegjshëm, si dhe të mbrojë përdoruesit nga dezinformimi.

sigurojnë shqyrtimin e vendosjes së reklamave dhe transparencën e reklamave politike, bazuar në kontrollet efektive të identitetit të sponsorëve; (ii) të mbyllin llogaritë e rreme aktive në shërbimet e tyre, dhe (iii) të identifikojnë robotët e automatizuar dhe t'i etiketojnë ata në përputhje me rrethanat. Platformat në internet duhet të bashkëpunojnë gjithashtu me rregullatorët kombëtarë audio-vizualë, si dhe me verifikues të pavarur të fakteve dhe me studiues për të zbuluar dhe vënë në dukje fushatat e dezinformimit, në veçanti gjatë periudhave zgjedhore, si dhe për ta bërë përmbajtjen e fakteve të verifikuara më të dukshme dhe më të përhapur.

**Komisioni, me ndihmën e Grupit Evropian të Rregullatorëve për Shërbimet e Medias Audio-vizuale (ERGA)<sup>36</sup>, do të monitorojë zbatimin e angazhimeve nga nënshkruesit e Kodit të Praktikës dhe do të informojë rregullisht nëse platformat individuale po i përmbushin këto angazhime dhe në çfarë mase. Për të mundësuar monitorim efektiv dhe gjithëpërfshirës, deri në fund të këtij viti platformat duhet t'i japin Komisionit informacion të përditësuar dhe të plotë mbi veprimet që kanë ndërmarrë për përmbushjen e këtyre angazhimeve. Komisioni do ta publikojë këtë informacion në janar 2019. Platformat duhet të ofrojnë gjithashtu informacion të plotë, përfshirë duke iu përgjigjur kërkesave specifike të Komisionit, se si po i zbatojnë angazhimet në baza të rregullta, duke filluar në janar 2019, në mënyrë që të mundësohet një monitorim i shënjestruar i pajtueshmërinë me Kodin përpara zgjedhjeve të Parlamentit Evropian. Edhe ky informacion gjithashtu do të publikohet.**

Përveç kësaj, Kodi i Praktikës parasheh që nënshkruesit do të japin një raport të plotë pas 12 muajsh. Këto raporte duhet të përfshijnë të dhëna dhe informacione të plota për të mundësuar një vlerësim të plotë nga ana e Komisionit. **Mbi këtë bazë, Komisioni, i ndihmuar nga ekspertiza e pavarur dhe me ndihmën e ERGA-s, do të vlerësojë efektivitetin e përgjithshëm të Kodit të Praktikës.** Komisioni mund të kërkojë gjithashtu ndihmën e observatorit evropian audio-vizual.

Komisioni vëren se efektiviteti i përgjithshëm i Kodit varet nga pjesëmarrja sa më e gjerë e mundshme e platformave online dhe e sektorit të reklamimit online. Prandaj, i bën thirrje aktorëve të tjerë përkatës që t'i përmbahen Kodit.

**Veprimi 6:** Komisioni do të sigurojë një monitorim nga afër dhe të vazhdueshëm të zbatimit të Kodit të Praktikës. Aty ku është e nevojshme, dhe në veçanti, në funksion të zgjedhjeve evropiane, Komisioni do të nxisë për një pajtueshmëri të shpejtë dhe efektive. Komisioni do të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës në përfundim të periudhës fillestare të zbatimit të Kodit prej 12 muajsh. Nëse zbatimi dhe ndikimi i Kodit të Praktikave do të rezultojnë të pakënaqshëm, Komisioni mund të propozojë masa të mëtejshme, duke përfshirë masa me natyrë rregullatore.

## **SHTYLLA 4: RITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE PËRMIRËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SHOQËRORE**

**Ndërgjegjësimi më i madh publik është thelbësor për përmirësimin e qëndrueshmërisë shoqërore ndaj kërcënimit që paraqet dezinformimi.** Pika fillestare është një të kuptuar më i mirë i burimeve të dezinformimit, si dhe i qëllimeve, mjeteve dhe objektivave që qëndrojnë pas dezinformimit, por edhe i vetë pikave tona të dobëta. Një metodologji e shëndoshë

---

<sup>36</sup> Grupi i Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet e Medie Audio-vizuale përfshin të gjithë rregullatorët përkatës të të gjitha Shteteve Anëtare. Ai i jep këshilla teknike Komisionit në një numër fushash që lidhen me zbatimin e Direktivës, lehtëson bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve rregullatore kombëtare dhe / ose organeve, si dhe ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullatore dhe / ose organeve dhe Komisionit. Direktiva e rishikuar e Shërbimeve të Medias Audio-vizuale përforcon më tej rolin e këtij Grupi, në veçanti lidhur edhe me platformat për ndarjen e videove.

shkencore mund të ndihmojë për identifikimin e dobësive kryesore në Shtetet Anëtare<sup>37</sup>. Është thelbësore të kuptohet se si dhe pse qytetarët, dhe nganjëherë edhe komunitete të tëra, tërhiqen nga narrativat dezinformuese dhe përcaktojnë një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj këtij fenomeni.

Ndërtimi i elasticitetit përfshin gjithashtu trajnime të specializuara, konferenca publike dhe debate, si dhe forma të tjera të të mësuarit të përbashkët për median. Ai përfshin gjithashtu fuqizimin e të gjithë sektorëve të shoqërisë dhe në veçanti, përmirësimin e njohurive mediatike të qytetarëve për të kuptuar se si të dallojnë dhe të shmangin dezinformimin.

Një reagim gjithëpërfshirës ndaj dezinformimit kërkon pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile. **Komunikata dhe Rekomandimi<sup>38</sup>, që janë pjesë e grupit të masave për sigurimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme evropiane (Paketa e Zgjedhjeve) u bëri thirrje Shteteve Anëtare të angazhohen me median, platformat online, ofruesit e teknologjisë së informacionit dhe të tjerë, në aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit për të rritur transparencën e zgjedhjeve dhe për të ndërtuar besimin te proceset zgjedhore. Në këtë kontekst nevojitet angazhimi aktiv dhe ndjekja nga ana e Shteteve Anëtare në prag të zgjedhjeve evropiane.**

**Verifikuesit e pavarur të fakteve dhe studiuesit luajnë një rol kyç për çuarjen përpara të të kuptuarit të strukturave që mbështesin dezinformimin dhe mekanizmat që formojnë mënyrën se si shpërndahet ai në internet.** Për më tepër, përmes veprimtarisë së tyre, ata rrisin ndërgjegjësimin për lloje të ndryshme të kërcënimeve të dezinformimit dhe mund të kontribuojnë për zbutjen e ndikimit të tyre negativ. Është e nevojshme të forcohen kapacitetet e tyre për të identifikuar dhe ekspozuar kërcënimet e dezinformimit, si dhe për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkuftar. Duke u bazuar në veprimet e përshkruara në Komunikatën e prillit, është e nevojshme të shtojmë ekipet multidisiplinare kombëtare të verifikuesve të pavarur të fakteve dhe studiuesve akademikë me njohuri specifike rreth mjediseve vendore të informacionit. Kjo kërkon mbështetjen dhe bashkëpunimin e Shteteve Anëtare në mënyrë që të lehtësohet funksionimi i rrjetit evropian të verifikuesve të fakteve, në respekt të plotë të pavarësisë së veprimtarive të verifikimit të fakteve dhe atyre kërkimore. Në kuadër të programit të Instrumentit për Ndërlidhjen e Evropës<sup>39</sup>, Komisioni do të financojë një platformë digjitale, e cila do të ndërlidhë së bashku ekipet e pavarura multidisiplinare kombëtare.

Për të rritur ndërgjegjësimin dhe qëndrueshmërinë e publikut, Komisioni do të rrisë më tej përkushtimin e tij dhe aktivitetet aktuale në lidhje me njohuritë mediatike për fuqizimin e qytetarëve të Bashkimit Evropian për të identifikuar dhe trajtuar më mirë dezinformimin<sup>40</sup>. Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë me shpejtësi dispozitën e Direktivës së rishikuar të Shërbimit të Medias Audio-vizuale, që kërkon që ata të promovojnë dhe zhvillojnë aftësitë për njohuritë mbi mediet<sup>41</sup>.

Në propozimin e tij për programin “Horizon Europe”<sup>42</sup> Komisioni ka propozuar fonde për zhvillimin e mjeteve të reja për të kuptuar më mirë dhe për të luftuar dezinformimin në

<sup>37</sup> Kjo mund të hulumtohet më tej si pjesë e punës së Monitorit të Pluralizmit të Medias, një projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe i realizuar nga Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias në Firence.

<sup>38</sup> Shih Rekomandimin e Komisionit për rrjetet e bashkëpunimit zgjedhor, transparencën në internet, mbrojtjen kundër incidenteve të sigurisë kibernetike dhe fushatat e luftës kundër dezinformimit në kontekstin e zgjedhjeve në Parlamentin Evropian, C (2018) 5949.

<sup>39</sup> Rregullorja (BE) Nr. 1316/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, për krijimin e një Instrumenti të Ndërlidhjes së Evropës, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 913/2010 dhe shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 680/2007 dhe (KE) Nr. 67/2010.

<sup>40</sup> Aktivitete të tilla do të përfshijnë një bibliotekë online të Bashkimit Evropian për njohuritë mediatike, si dhe mjete të tjera të njohurive mediatike.

<sup>41</sup> Neni 33a i Direktivës së rishikuar të Shërbimit të Medias Audio-vizuale

<sup>42</sup> Komunikata (2018) 435

internet. Komisioni do të mbështesë gjithashtu, sipas rastit, fushata informative për të rritur ndërgjegjësimin e përdoruesve mbi teknologjitë më të fundit (p.sh., teknikat deep-fakes).

**Puna e medieve të pavarura është thelbësore për funksionimin e një shoqërie demokratike.** Prandaj Komisioni<sup>43</sup> do të vazhdojë t'i mbështesë mediet e pavarura dhe gazetarët investigativë, pasi ata kontribuojnë për ekspozimin e dezinformimeve. Përveç kësaj, Komisioni do të vazhdojë të ndërmarrë programe specifike në lidhje me mbështetjen e medias, duke përfshirë mbështetjen financiare dhe profesionalizimin në vendet e tij fqinje<sup>44</sup>.

**Veprimi 7:** Duke pasur parasysh veçanërisht zgjedhjet evropiane të vitit 2019, por edhe periudhën afatgjatë, Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, do të organizojnë fushata që synojnë publikun, si dhe trajnime për mediet dhe formuesit e opinionit publik në Bashkimin Evropian dhe vendet e tij fqinje, për të rritur ndërgjegjësimin mbi efektet negative të dezinformimit. Përpjekjet për të mbështetur punën e medias së pavarur dhe gazetarinë cilësore, si dhe studimet mbi dezinformimin do të vazhdojnë, me qëllim që të sigurojnë një reagim gjithëpërfshirës ndaj këtij fenomeni.

**Veprimi 8:** Shtetet Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, duhet të mbështesin krijimin e ekipeve të verifikuesve të pavarur të fakteve dhe studiuesve multidisiplinarë me njohuri specifike të mjediseve vendore të informacionit, për të zbuluar dhe ekspozuar fushatat e dezinformimit në rrjete të ndryshme sociale dhe në mediet digjitale.

**Veprimi 9:** Si pjesë e Javës së Njohurive Mediatike në mars 2019, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, Komisioni do të mbështesë bashkëpunimin ndërkufitar midis praktikuesve të njohurive mediatike, si dhe prezantimin e mjeteve praktike për promovimin e njohurive mediatike për publikun. Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë gjithashtu me shpejtësi dispozitat e Direktivës së Shërbimeve të Medias Audio-vizuale, të cilat merren me njohuritë mediatike.

**Veprimi 10:** Duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme evropiane të vitit 2019, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë ndjekjen efektive të Paketës Zgjedhore, veçanërisht Rekomandimin. Komisioni do të monitorojë nga afër se si zbatohet Paketa dhe aty ku është e përshtatshme, do të ofrojë mbështetjen dhe këshillat përkatëse.

#### 4. KONKLUZIONE

Dezinformimi është një sfidë e madhe për demokracitë dhe shoqëritë evropiane dhe Bashkimi Evropian duhet ta trajtojë atë duke i qëndruar besnik vlerave dhe lirive evropiane. Dezinformimi minon besimin e qytetarëve të demokracisë dhe institucionet demokratike. Dezinformimi kontribuon gjithashtu në polarizimin e pikëpamjeve të publikut dhe ndërhyr në proceset demokratike të vendimmarrjes. Ai mund të përdoret gjithashtu për të minuar projektin evropian. Kjo mund të ketë efekte të konsiderueshme negative në shoqëri në të gjithë Bashkimin Evropian, veçanërisht në prag të zgjedhjeve të Parlamentit Evropian të vitit 2019.

Angazhimi i fortë dhe veprimet e shpejta janë të domosdoshme për të ruajtur procesin demokratik dhe besimin e qytetarëve tek institucionet publike, si në nivel kombëtar, ashtu

---

<sup>43</sup> Programi “Evropa Kreative”, nëse miratohet, do të ndihmojë për forcimin e sektorit të shtypit të Evropës, diversitetit dhe pluralizmit të përmbajtjes gazetareske, si dhe qasjes kritike ndaj përmbajtjes së medias përmes njohurive mediatike, Komunikata (2018) 438.

<sup>44</sup> Komisioni financon projektin "openmediahub": (i) për t'u siguruar gazetarëve në vendet fqinje aftësitë e nevojshme për raportim të pavarur dhe objektiv; (ii) për të përmirësuar aftësitë e stafëve të redaksive dhe (iii) për të përforcuar rrjetin e profesionistëve të medias dhe gazetarëve në vendet fqinje. Sa i përket Ballkanit Perëndimor, Komisioni po siguron mbështetje financiare për ngritjen e një rrjeti të shoqatave gazetareske, ndërtimin e besimit të media dhe përforcimin e sistemeve gjyqësore për mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Në këtë fushë, Komisioni mbështet gjithashtu mediet e shërbimit publik, organet e reja dhe të pavarura të shtypit, si dhe përmirësimin e cilësisë dhe profesionalizmit në gazetari.

edhe në nivelin e Bashkimit Evropian. Ky Plan Veprimi përcakton veprimet kryesore për trajtimin e dezinformimit me një qasje të koordinuar të institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve Anëtare. Ai thekson gjithashtu masat që duhet të merren me përparësi nga aktorë të ndryshëm përpara zgjedhjeve të Parlamentit Evropian të vitit 2019. Shtetet Anëtare duhet të rritin solidaritetin e tyre dhe ta mbrojnë Bashkimin Evropian nga sulmet hibride, duke përfshirë sulmet që përdorin dezinformimin.

Në të njëjtën kohë, dhe në periudhën afatgjatë, objektivi është që Bashkimi Evropian dhe fqinjët e tij të bëhen më të qëndrueshëm ndaj dezinformimit. Kjo kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme për të mbështetur arsimin dhe njohuritë mediatike, gazetarinë, verifikuesit e fakteve, hulumtuesit dhe shoqërinë civile në tërësi.

Prandaj Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë:

- kujtojnë se kërkohet veprimi i përbashkët nga të gjithë aktorët përkatës institucionalë, si dhe nga sektori privat, veçanërisht nga platformat online dhe shoqëria civile në tërësi për të trajtuar në mënyrë efektive të gjitha aspektet e ndryshme të kërcënimit të dezinformimit;
- i bëjnë thirrje Këshillit Evropian që ta miratojë këtë Plan Veprimi;
- u bëjnë thirrje Shteteve Anëtare të bashkëpunojnë për zbatimin e veprimeve të përcaktuara në këtë Plan Veprimi;
- si një çështje me përparësi, u bëjnë thirrje të gjithë aktorëve përkatës që të zbatojnë ato veprime që janë urgjente dhe me rëndësi në prag të zgjedhjeve të ardhshme evropiane në maj 2019.